


REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



## **KONTRATË MBI ANKANDIN PUBLIK** **Shitja e masës drusore të pa prera ( në këmbë) në njësin e Zhegocit** **(Kishnapole)**

**ngastra nr54(02.04) / Lot I**

me numër identifikues: *Gi 651 -18-003*

*neni 1. Lënda*

**Kjo kontratë e lidhur me datën 14/08/2018 në mes të: Komunës së Gjiçanit** këtu e tutje i referuar me “Autoriteti Kontraktues”), në njërën anë,

**dhe N.T. “DAJA” nga Prishtina** (këtu e tutje i referuar si “Blerësi”), në anën tjetër:

**NDËRSA** Autoriteti Kontraktues ka ftuar ofertuesit për **Shitja e masës drusore të pa prera ( në këmbë) në njësin e Zhegocit fshati Zhegoc (Kishnapole), ngastra nr.54(02.04) lot I**

dhe ka pranuar tenderin me çmimin më të lartë të dorëzuar nga blerësi për blerjen e kësaj mase drusore.

**TANI KJO MARRËVESHJE DËSHMON SI NË VIJIM:**

1. Blerësi pajtohet të paguaj në dy këste për masën drusore (dru të pa prera) edhe atë kësti i par i cili është edhe avans 40 % të vlerës së kontratës ( ku ky këst merret edhe si sigurim i kontratës), kurse kësti i dytë do të paguhet në shumën mbetur të pagesës e cila do të bihet pas palimit dhe matjes së druve të cilin do ta bëjë një komision i **veçantë** nga Drejtorati i Bujqësisë.

1.1.1 Kontraktori nuk do të filloj me tërheqjen e masës drusore e cila ka qen objekt i ankandit publik pa e bërë pagesën në tërësi sipas çmimit të fundit të dhënë në ankand nga ana e vetë blerësit.

2. Duke konsideruar pagesat e kryera nga Blerësi, Autoriteti Kontraktues, siç theksohet në Kontratë, pajtohet të lejoj bartjen e masës drusore në pajtim me dispozitat e kontratës.
3. **Kontraktori do të filloj me tërheqjen e masës drusore mbrenda (5 ditë) pasë nënshkrimit të kontratës, dhe menjëherë pas pagesës së tyre, afati për tërheqjen e masës drusore është 120 ditë pune nga dita e fillimit të tërheqjes (plani dinamik i tërheqjes).**
4. Nëse kontraktori gjendet duke vepruar në pyll në kundërshtim me ligjin, duke prerë dhe transportuar masë drusore jashtë sasisë së paraparë me këtë kontratë apo duke transportuar pa lejen e Autoritetit Pyjor automatikisht I ndërpritet kontrata dhe ndaj tij do të inicohet procedure gjyqësore si dhe do ti ndalohet aplikimi I mëtutjeshëm nëpër Ankande publike dhe tenderë.

## **Neni 2 Lokacioni i masës drusore**

2.1 Lokacioni i masës drusore ( dru në këmbë) është në ngastren nr. 54(02.04)Zhegoc- Kishna Pole

2.2 Zyrtaari që duhet kontaktuar për aranzhimin e marrjes së masës drusore ( dru në këmbë) është Autoriteti Pyjor Komunal - i cili do ta caktoj një komision që do ta vëzhgoj kontraktorin gjatë tërheqjes së masës drusore dhe në fund do ta përpiloj një procesverbal mbi sasinë e masës drusore ku do të nënshkruaj si komisioni ashtu edhe kontraktori.

**2.3 Sasia Bruto(m<sup>3</sup>)( vëllimi ) dhe lloji i druve:1,664.00**

## **Neni 3 Çmimi i kontratës**

4.1 Çmimi total do të jetë: **60,315.40 €**;

*shëno çmimin me fjalë: Gjashtëdhjetëmijë e treqind e pesëmëdhjetë Euro e katërdhjetë cent.*

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 është një sasi e cila mund të ndryshoj për shkak të specifikave të druve pasi që drutë janë shitur të pa prera e kontraktori pas prerjes dhe palimit të tyre do të dihet saktë sasia e masës drusore ku çmimi për njësi do të dominoj.

3.3 Çmimi për njësi do të jetë përfundimtar dhe nuk do të ndryshohet.

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme të kontratës

## **Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (c) Përshkrimi i Aseteve; masë drusore ( dru në këmbë)



(d) Ankandi i mbajtur me datën 18/06/2018.





4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Blerësit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhet me shkrim. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Blerësin.

	Për Autoritetin Kontraktues	Për Blerësin	
<b>Emri:</b>	Izet Kurteshi	<b>Emri:</b>	Fitim Gjata
<b>Pozita:</b>	Ud.Menaxher i Zyrës së Prokurimit	<b>Pozita:</b>	Drejtor
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	15/08/2018	<b>Data:</b>	15/08/2018
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	
	<b>Për Autoritetin Kontraktues</b>		
<b>Emri:</b>	Shqipe Hoxha		
<b>Pozita:</b>	E autorizuar per nenshkrime ne Zyrës së Prokurimit		
<b>Nënshkrimi:</b>			
<b>Data:</b>	15/08/2018		
<b>Vula:</b>	